



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **23.10.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të çështjes penale nr.49/1 të vitit 2025, në ngarkim të të pandehurit **Kristian Shkreli**, i akuzuar për veprën penale të “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 të K.Penal”.

2. Në seancën e datës 05.12.2025 (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 112, 13 pika 3/1, 75/a shkronja b, 332, 332/a, 332/b, 332/c, 332/dh, 332/e dhe 332/ë të K.Pr.Penale, me vendimin nr. **159**, datë **05.12.2025**, vendosi:

1. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr.49/1 të vitit 2025 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurit **Kristian Shkreli**, atësia L., amësia M., datëlindje ****, lindur në **** dhe banues në ****, ndërtesa nr. ****, hyrja nr. ****, ****, me arsim ****, me gjendje civile ****, me gjendje gjyqësore ****, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 të K.Penal, trupit gjykues të përbërë prej 3 gjyqtarësh të ndryshëm në tërësi nga ky trup gjykues monokratik, dhe hedhjen e çështjes në short, për arsye se gjykata çmon se ka prova të mjaftueshme në favor të akuzës.
2. Fashikulli i gjykimit përcaktohet të përmbajë të gjithë aktet e kryera gjatë fazës së hetimit paraprak dhe konkretisht të përfshihen në volumnin e parë me 431 fletë plus fleta e inventarit, volumni nr.2 me 232 fletë plus fleta e inventarit, volumni nr.3 me 234 fletë plus fleta e inventarit, volumni nr.4 me 324 fletë plus fletën e inventarit si edhe urdhërin për bashkimin e provës materiale me çështjen dhe provën përkatëse dhe aktet e paraqitura në seancën e sotme paraprake, duke përjashtuar procesverbalet ku janë dokumentuar deklaratimet e shtetasve që kanë dijeni për veprën penale dhe personi nën hetim apo të pandehur për shkak se nuk mund të përdoren drejtëpërdrejtë në atë gjykim.
3. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

4. Urdhërohet depozitimi i këtij vendimi dhe fashikulli i gjykimit në sekretarinë e kësaj gjykate brenda 10 ditëve.

Tiranë, më datë 06.12.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar